

UNIVERSITETI I PRISHTINËS ‘HASAN PRISHTINA

Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë

Departamenti i Mbrojtjes së Bimëve



PUNIM I DIPLOMËS MASTER

Përhapja e sëmundjeve të ndryshme në kulturën e specit në mjedise të mbrojtura
me theks të veçantë *Colletotrichum gloeosporioides*

Mentor:

Prof. Asoc. Dr. Fadil Musa

Kandidatja:

Bsc. Kosovare Istogu

Qershor, 2023

ABSTRAKTI

Speci (*Capsicum annum*) është një nga kulturat perimore më të njohura në të gjithë botën. Si e tillë kjo kulturë me të madhe kultivohet edhe në vendin tonë për çdo vit duke zënë sipërfaqe të konsiderueshme në mesin e kulturave perimore. Kultivimi i kësaj kulture çdo ditë e më shumë është në rritje e sipër si e freskët për konsum, sallatë si dhe si përbërës apo lëndë e parë në shumë ushqime. Speci i kultivuar në serrë, respektivisht në mjedise të mbrojtura është i ndjeshëm ndaj prekjës nga një numër mjaft i madh i sëmundjeve të cilat prekin këtë kulturë në të gjitha fazat e zhvillimit.

Këto sëmundje shkaktohen nga kërpurdhat fitopatogjene, bakteret, viruset, etj., sëmundje këto të cilat ndikojnë negativisht në cilësinë, sasinë dhe shëndetin e bimëve të specit. Nga sëmundjet të cilat prekin specin pa dyshim se antraknoza shfaqet për çdo vit në vendin tonë duke i shkaktuar dëme të konsiderueshme kësaj kulture. Antraknozën e specit e shkakton kërpudha fitopatogjene *Colletotrichum gloeosporioides*, është sëmundje e rëndësisë së veçantë e cila gjatë infektimit të kulturës ulë cilësinë dhe rendimentin me ç'rast humbjet e tërësishme sipas hulumtimeve të autorëve të ndryshëm mund të shkojnë deri në 80%.

Hulumtimi i ndjeshmërisë së hibrideve të specit ndaj patogjenit *Colletotrichum gloeosporioides* në mjediset e mbrojtura është zhvilluar në rajonin e Skenderajit, në fshatin Rrezallë e Re dhe Qubrel, përkatësisht në dy serra në të njëjtat lokalitete me tre kultivarë të përfshirë të specit (Sobri, Kapitan dhe Amyka). Eksperimenti është realizuar sipas metodës së blloqeve të randomizuara të Fisherit në tri përsëritje. Në secilën përsëritje janë kontrolluar nga 10 bimë të specit gjatë tërë periudhës së vegjetacionit ku në intervale një javore janë marrë mostrat për analizë.

Mostrat e marra në këtë mënyrë në mjedise të mbrojtura janë mbjellur në baza ushqyese (Nutrition Agar dhe Potato Dextrose Agar) në mënyrë që të identifikohen patogjenët prezent. Për identifikimin e llojeve të paraqitura të patogjenëve në kulturen e specit janë përdorur çelësa dhe atlase të ndryshme fitopatologjike, ndërsa përpunimi statistikor i rezultateve është bërë përmes programit MSTAT-C.

Rezultatet dhe të dhënat të cilat janë arritur gjatë këtyre hulumtimeve kanë rëndësi shkencore dhe praktike sepse për herë të parë kemi të dhëna mbi përhapjen dhe prekjen e hibrideve të specit nga sëmundjet e ndryshme me theks të veçantë nga patogjeni *Colletotrichum gloeosporioides*, që shkakton antraknozën e specit dhe ndjeshmërinë që kanë këto hibride ndaj patogjenit në mënyrë praktike, ku edhe fermerët me kohë dhe në mënyrë profesionale do të njoftohen për rrezikshmërinë e infektimit si dhe mënyrat më të mira të mbrojtjes jo vetëm nga ky patogjen, por edhe sëmundjeve të tjera.

ABSTRACT

Pepper (*Capsicum annum*) is one of the most popular vegetable crops around the world. As such, this largest crop is also cultivated in our country every year, occupying a significant area among vegetable crops. Cultivation of this culture is increasing every day and it is used for fresh consumption, salad as well as an ingredient in many foods. Pepper grown in greenhouses or in protected environments is susceptible to being affected by a large number of diseases that affect this crop in all stages of his development.

These diseases are caused by phytopathogenic fungi, bacteria, viruses, etc. which negatively affect the quality, quantity and health of pepper plants. Of the diseases that affect pepper, there is no doubt that anthracnose appears every year in our country, causing significant damage to this crop. Anthracnose of pepper is caused by the phytopathogenic fungus *Colletotrichum gloeosporioides*, it is a disease of particular importance which during the infection of the pepper plants reduces the quality and yield, in which case total losses according to the researches of different authors can go up to 80%.

The investigation of the sensitivity of pepper hybrids to the pathogen *Colletotrichum gloeosporioides* in protected environments was developed in the region of Skenderaj, in the village of Rrezalle e Re and Qubrel, respectively in two greenhouses in the same localities with three cultivars of pepper involved (Sobri, Kapitan, and Amyka). The experiment was carried out according to Fisher's randomized block method in three replications. In each repetition, 10 pepper plants were checked during the entire vegetation period, where samples were taken for analysis at one-week intervals.

The samples obtained in this way in protected environments are planted on nutritional bases (Nutrition Agar and Potato Dextrose Agar) in order to identify the pathogens present. Different keys and phytopathological atlases were used to identify the types of pathogens present in the pepper crop, while the statistical processing of the results was done through the MSTAT-C program.

The results and data obtained during these researches are of scientific and practical importance because for the first time we have data on the spread and impact of pepper hybrids by various diseases with special emphasis on the pathogen *Colletotrichum gloeosporioides* that causes pepper anthracnose and the sensitivity that these hybrids have to the pathogen in a practical way, where the farmers will be informed in time and in a professional manner about the danger of infection as well as the best ways of protection not only from this pathogen but also from other diseases.